



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.12.2021)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

1.1 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 180, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

1.2 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 182, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 11:49.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |

7. *Alban Toro* (anëtar)  
8. *Marçela Shehu* (anëtare)  
9. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

**Shënim:** Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami* dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
2. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

1.1 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 180, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

1.2 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 182, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

**Maksim Qoku:** Përshëndetje të nderuar anëtarë.

Sot zhvillojmë mbledhjen me rend dite paksa të ndryshëm për efekt të emergjencës që kanë këto çështje.

Mbledhja do të drejtohet nga unë Zëvendëskryetari për shkak të mungesës së Kryetares e cila është e zënë me angazhimet në punët e Këshillit.

Rendi i ditës sot ka tre çështje kryesore.

Çështja e parë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 180, datë 28.05.2020, të

Këshillit të Lartë Gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Çështja e dytë gjithashtu është shqyrtimi i projektvendimit "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 182, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor", relator z. Alban Toro.

Çështja e tretë: Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme".

Nëse nuk ka gjë nga anëtarët për rendin e ditës, vazhdojmë me çështjen e parë.

Fjala për relatorin.

Fjala për ju zoti Toro!

***Alban Toro:*** Faleminderit!

Në kuadër të emërimit dhe plotësimit të disa pozicioneve të lira të hapura në shkallë të ndryshme të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, ndër të tjera edhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, nga ana e Këshillit është disponuar me vendime të veçanta duke filluar procedurat e ngritjes në detyrë, fillimisht për 5 pozicione të lira në fushën e së drejtës civile dhe respektivisht me vendimet nr. 179, nr. 180, nr. 181, nr. 182 dhe nr. 183, datë 28.05.2020.

Në formë tabelare ju kam paraqitur pozicionet e lira dhe kandidatët të cilët kanë konkurruar për këto pozicione të lira. Natyrisht nga ana e Këshillit është realizuar procedura e verifikimit për secilin nga ata në lidhje me kriteret paraprake (pra përvoja profesionale minimale, mospasja masë disiplinore në fuqi, mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale, dhe njëkohësisht pasuria dhe figura).

Ndërkohë që paralelisht me këtë procedurë ka filluar edhe procedura e verifikimit të kriterëve të tjera të kandidimit si dhe ato të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për pozicionet e lira, si dhe verifikimi i kriterit të pasurisë dhe figurës.

Për njëmbëdhjetë kandidatët në garë në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pesë pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikoi plotësimin nga ata të gjithë kriterëve të kandidimit, duke

vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurave respektive të ngritjes në detyrë për pozicionet e lira ku kanë kandiduar. Konkretisht:

1) Për znj. {...}, e cila ka kandiduar për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë me Vendimet nr. 182 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, kandidate për të cilën Këshilli, me Vendimin nr. 169, datë 22.04.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;

2) Për znj. {...}, e cila ka kandiduar për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me Vendimet nr. 182 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, nga ana e Këshillit është disponuar me Vendimin nr. 102, datë 18.03.2021, duke vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;

3) Për znj. {...}, e cila ka kandiduar për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me Vendimet nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, Këshilli ka disponuar me Vendimin nr. 649, datë 29.12.2020, duke vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;

4) Për znj. {...}, e cila ka kandiduar për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë me Vendimet nr. 179, nr. 181 dhe nr. 182, datë 28.05.2020, Këshilli ka disponuar me Vendimin nr. 101, datë 18.03.2021, duke vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;

5) Për znj. {...}, e cila ka kandiduar për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë me Vendimet nr. 180 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, Këshilli ka disponuar me Vendimin nr. 650, datë 29.12.2020, duke vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;

6) Për znj. {...}, e cila ka kandiduar për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me Vendimet nr. 179, nr. 180 dhe nr. 182, datë 28.05.2020, Këshilli ka disponuar me Vendimin nr. 651, datë 29.12.2020, duke vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;

7) Për z. {...}, i cili ka kandiduar edhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë me Vendimin

nr. 181, datë 28.05.2020, nga ana e Këshillit është disponuar me Vendimin nr. 168, datë 22.04.2021, duke vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;

8) Për znj. {...}, e cila ka kandiduar për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë me Vendimet nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, Këshilli ka disponuar me Vendimin nr. 270, datë 28.06.2021, duke vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;

9) Për znj. {...}, e cila ka kandiduar për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë me Vendimin nr.179, datë 28.05.2020, me Vendimin nr. 499, datë 21.10.2020, Këshilli ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;

10) Për znj. {...}, e cila ka kandiduar për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë me Vendimin nr. 183, datë 28.05.2020, Këshilli ka disponuar me Vendimin nr. 205, datë 20.05.2021, duke vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;

11) Për znj. {...}, e cila ka kandiduar për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë me Vendimet nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, Këshilli ka disponuar me Vendimin nr. 453, datë 19.10.2020, duke vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Siç kam theksuar edhe më lart, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, për këto kandidatët kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 dhe vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2019.

Ndërkohë, ndërsa vijonin procedurat e verifikimit të kriterëve të kandidimit, me Vendimin nr. 56, datë 16.02.2021, Këshilli filloi procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë duke caktuar edhe relatorin përkatës.

Relatori, pasi ka administruar dokumentacionin përkatës për secilin kandidat të kualifikuar, duke analizuar dosjet e tyre personale apo praktikat dokumentare të

procedurave të verifikimit të plotësimit të kriterit të kandidimit si dhe vendimet në lidhje me vlerësimet etike dhe profesionale, ka vijuar më tej me analizën përkatëse.

Më duhet të theksoj se një nga kandidatet, zonja {...}, ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit dy vendimet e Këshillit për vlerësimin etik dhe profesional të saj. Po ashtu, për dy nga kandidatët, znj. {...} dhe znj. {...}, ende nuk ka përfunduar afati i përcaktuar nga ligji për ankimin e vendimeve të Këshillit për vlerësimin e tyre etik dhe profesional. Gjithashtu, për tre kandidatë të tjerë, znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}, Këshilli ende nuk ka përfunduar procesin e vlerësimit etik dhe profesional.

Kështu që, në këto kushte mbetet që të mbyllen vetëm procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 180 dhe nr. 182, datë 28.05.2020, të cilat janë përfundimtare dhe kanë vendimet e formës së prerë dhe të paankimuara nga kandidatët në fjalë.

Në këto kushte, në lidhje me kandidaten {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 384 dhe nr. 385, datë 22.09.2021, vendime të cilat janë përfundimtare, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar shkresës nr. {...} prot., datë 15.11.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Ndërkohë për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 421 dhe nr. 422, datë 29.09.2021, vendime të cilat janë përfundimtare, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar shkresës nr. {...} prot., datë 15.11.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 382 dhe nr. 383, datë 22.09.2021, vendime të cilat janë përfundimtare, dhe nuk ka ankim referuar Gjykatës Administrative të Apelit.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 357 dhe nr. 358, datë 14.09.2021, dhe për to nuk është paraqitur ndonjë ankim, konfirmuar kjo nga gjykata e apelit.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 297 dhe nr. 298, datë 13.07.2021, vendime të cilat janë përfundimtare dhe të paankimuar nga kandidatja, referuar kjo aktit nr. 3310/2, datë 20.09.2021, përmes të cilës është shprehur se pasi është njohur me vendimet e arsyetuara, ka deklaruar se nuk ka ankim ndaj tyre.

Kështu që, në vështrim të nenit 48, pika 9, të ligjit për Statusin, pika 14 e nenit 48 të ligjit për Statusin, referuar kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për kandidatët u konstatua si më poshtë:

Për znj {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 357, datë 14.09.2021, kandidatja është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas Vendimit të Këshillit nr. 358, datë 14.09.2021, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”;

Për znj. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 297, datë 13.07.2021, kandidatja është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, “Shkëlqyeshëm”; Sipas Vendimit të Këshillit nr. 298, datë 13.07.2021, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që kandidatja znj. {...}, të ketë “Shkëlqyeshëm” dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kurse kandidatja znj. {...}, dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i ka “Shkëlqyeshëm” dhe “Shumë mirë”. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke pasur parasysh pesë nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të Ligjit për Statusin, arrihet të identifikohet kandidati me rezultatet më të larta, pikërisht znj. {...}. Mbi këtë bazë u procedua edhe për renditjen e kandidatëve, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 180, datë 28.05.2020, ku më lart renditet znj. {...}, ndërsa kandidatja tjetër znj. {...} renditet pas saj.

Për pasojë, nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, renditja e kandidatëve për pozicionin

e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 180, datë 28.05.2020, është si më poshtë:

1.Znj. {...};

2.Znj. {...}.

Në lidhje me këtë është përgatitur projektvendimi përkatës, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 180, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1) Znj. {...};

2) Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...} dhe znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kjo është në lidhje me projektvendimin e parë.

Nëse duhet të procedojë më tej.

***Maksim Qoku:*** Faleminderit, zoti Toro!

Procedojmë me votimin e këtij, pastaj me tjetrin.

***Alban Toro:*** Atëherë, relatori është dakord.

Maksim Qoku: Faleminderit, zoti Toro!

Nëse nuk kanë anëtarët gjë për të shtuar, mund të kalojmë në proces votimi.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ilir Toska:*** Dakord.



**Alban Toro:** Dakord përsëri.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Medi Bici:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi vendimin e sa më sipër relatuar nga relatori zoti Toro.

**Maksim Qoku:** Kalojmë tashmë në relativimin e projektvendimit të dytë.

Fjala për ju zoti Toro!

**Alban Toro:** Më tej, në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 182, datë 28.05.2020, u përfshinë katër kandidatë, konkretisht: znj. {...}; znj. {...}; znj. {...} dhe znj. {...}. Për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjës për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e ngritjes në detyrë ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe kishin dy vlerësime etike dhe profesionale, sikurse kërkohet për efekt renditjeje nga shkronja “a”, pika 9, e nenit 48, të Ligjit për Statusin apo shkronja “c”, pika 7 dhe në pikën 46, të Vendimit 70/2020.

Edhe në këtë procedurë përzgjedhjeje, për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, si dhe Kreu IV, të Vendimit 70/2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për znj. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 384, datë 22.09.2021, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas Vendimit të Këshillit nr. 385, datë 22.09.2021, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”;

Për znj. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 421, datë 29.09.2021, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm

“Shkëlqyeshëm”; Sipas Vendimit të Këshillit nr. 422, datë 29.09.2021, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”.

Për znj. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 382, datë 22.09.2021, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas Vendimit të Këshillit nr. 383, datë 22.09.2021, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”;

Për znj. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 297, datë 13.07.2021, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas Vendimit të Këshillit nr. 298, datë 13.07.2021, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që dy kandidatë, konkretisht znj. {...} dhe znj. {...}, të kenë “Shkëlqyeshëm” të dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kurse kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}, dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i kanë “Shkëlqyeshëm” dhe “Shumë mirë”. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke pasur parasysh pesë nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të Ligjit për Statusin , identifikohen dy kandidatë me rezultate të njëjta më të larta, konkretisht kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}, të cilat renditen më lart se kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}.

Ndërsa qëllimi i procedurës së përzgjedhjes është identifikimi i kandidatit me rezultatet më të larta, relatori analizoi përparësinë e dytë për kriterin e parë të renditjes, pra “përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit”, u konstatua se një nga kandidatët me rezultate të njëjta më të larta, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë, ka përvoja të tilla. Konkretisht, u konstatua se gjyqtarja {...} ka përvojë si gjyqtare e komanduar në pozicionin e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, referuar për këtë Vendimit nr. 56, datë 02.06.2015, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me të cilin kandidatja është lejuar të shërbejë për një afat 1-vjeçar, si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që sipas pikës 2 të këtij vendimi, pas përfundim të afatit të lejes, ajo rikthehej në pozicionin e mëparshëm, atë të gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Nisur nga përcaktimet pikave 8 dhe 15/b, të Vendimit 70/2020, ndërsa nga zbatimi përparësisë së dytë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit”, arrihet të identifikohet kandidati me rezultatet më të larta, pikërisht znj. {...}. Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 182, datë 28.05.2020, konkretisht si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...};
- 3) Znj. {...} dhe znj. {...}.

Në këto kushte, relatori ka përgatitur projektvendimin, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni si më poshtë:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 182, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...};
- 3) Znj. {...} dhe Znj. {...}

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Maksim Qoku:** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, nëse nuk ka gjë për të shtuar nga anëtarët, mund të kalojmë në votim.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Maksim Qoku*: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi vendimin e sa më sipër relatuar nga relatori.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.12.2021)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, relator z. Ilir Toska:

2.1 Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 552, datë 25.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

2.2 Për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z/znj \_\_\_\_, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në gjykatën e posaçme të apelit për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

2.3 “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 11:49.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 2. Medi Bici*** (anëtar)

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Brunilda Kadi* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ilir Toska* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

*Shënim:* Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami* dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
2. *Valbona Bako, Përgjegjëse pranë Sektorit të përgatitjes së dokumentacionit dhe përfaqësimit në gjykatë.*
3. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

## **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, relator z. Ilir Toska:

2.1 Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 552, datë 25.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

2.2 Për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z/znj \_\_\_\_, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në gjykatën e posaçme të apelit për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

2.3 “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Çështja e dytë e rendit të ditës ka në vetvete tre nënçështje.

Nënçështja e parë ka të bëjë me ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 552, datë 25.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Lidhur me këtë është përcjellë edhe relacioni shpjegues si vijon:

Mbi kërkesën nr. {...} prot., datë 22.11.2021, të Kryetares në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për caktimin e një gjyqtari për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 25.11.2021, ndër të tjera, ka shqyrtuar edhe këtë kërkesë, e cila identifikonte si nevojë të kësaj gjykate, në tabelë ka qenë çështja nr. 1, në lëndë civile dhe kërkohej caktimi i një gjyqtari.

Për këtë kërkesë të kryetares në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmit të skemës së delegimit dhe padobishmërisë së zbatimit të mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor zbatimin e nenit 170/1 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të Vendimit të tij nr. 30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Më konkretisht, në konsideratë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin IV, pika 5, të Vendimit të KLGJ-së nr. 30/2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ndër të tjera, ka propozuar:

1. Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

2. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 (dy).

Po ashtu, në konsideratë të përcaktimeve të paragrafit VIII të Vendimit të KLGJ-së nr. 30/2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar:

1. Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, konkretisht: Z. Markelian Koça.

2. Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2021, në një ose më shumë çështje në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Znj. Flora Hasimi, Z. Petraq Çuri, Z. Rexhep Bekteshi, Znj. Shpetime Pitaku, Z. Vladimir Skenderi, Z. Paulin Çera, Znj. Besjana Garxenaj.

Propozimet e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës janë pranuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ku mbi këtë bazë është zhvilluar procedura e shortit, për përzgjedhjen e 2 (dy) gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, edhe për gjykimin e çështjes gjyqësore të identifikuar në tabelë me numër rendor 1.

Mbi këtë bazë, me Vendimin Nr.552, datë 25.11.2021, paragrafi II, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, pika 1, Këshilli i Lartë Gjyqësor, për kërkesën ka vendosur:

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen civile me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, etj.; Objekti: “Zbatim marrëveshje”.

Mbas njoftimit të këtij vendimi, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me email-in e datës 26.11.2021, ka bërë me dije Këshillin e Lartë Gjyqësor se:

“...gjyqtarja {...} prej datës 15.08.2021 është me leje lindje”.

Sa më sipër, rezulton që një rrethanë të tillë Këshilli nuk e ka pasur parasysh në marrjen e Vendimit Nr.552, datë 25.11.2021, paragrafi II, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, pika 1, përmes të cilit është caktuar gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, {...}, e cila përkohësisht ka ndërprerë ushtrimin e funksionit, shkak për të cilin nuk duhet të ishte përfshirë në procedurat e shortit.

Në këto kushte, bazuar në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 99 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është vendi për ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, paragrafi I, të Vendimit Nr.552, datë 25.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sa i përket gjyqtarit të caktuar për gjykimin e çështjes civile si më lart.

Për gjyqtarin që duhet të caktohet për gjykimin e asaj çështjeje gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, në kushtet kur tashmë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, gjatë vitit 2021, të cilët janë caktuar në një ose më



shumë çështje në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, vetëm sa i përket propozimeve për përjashtimin nga shorti të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (Paragrafi C, pika 2), Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

1. Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka ndërprerë përkohësisht ushtrimin e funksionit për arsye shëndetësore, konkretisht: Znj. Nurjeta Tafa.

2. Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2021, në dy ose më shumë çështje në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z. Rexhep Bektashi, Z. Vladimir Skënderi.

3. Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili u caktua në shortin e datës 25.11.2021, në një çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, konkretisht: Z. Shpëtim Reka.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, paragrafi II, të Vendimit Nr.552, datë 25.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku në bazë të rezultateve të shortit, ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të caktohet 1 (një) gjyqtar për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen civile me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, etj.; Objekti: “Zbatim marrëveshje”.

*(Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime, ndaj propozimet e Komisionit konsiderohen të miratuara. Vijohet me procedurën e shortit.)*

Për çështjen me nr. 00120, përzgjidhet gjyqtari Paulin Çera.

Hidhet në votim projektvendimi:

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Medi Bici:** Dakord.

**Maksim Qoku:** Dakord.

Vijohet me nënçështjen e dytë “Për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në gjykatën e posaçme të apelit për korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Bashkë me projektvendimin është përcjellë edhe relacioni shpjegues, ku shkurtimisht parashtrohet se:

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me aktin nr. {...} prot., datë 01.12.2021, është regjistruar kërkesa e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me shkresën nr. {...}, prot., datë 26.11.2021, kundër të pandehurve: {...} dhe {...}, bazuar kjo kërkesë në nenin 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sipas nenin 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, “1. Në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka magjistratë të disponueshëm dhe transferimi i përkohshëm i magjistratëve është i padobishëm për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor, Këshillat mund të caktojnë një magjistrat për gjykimin ose hetimin e çështjeve të veçanta në një gjykatë ose prokurori të ndryshme nga ajo ku ai ushtron funksionin në mënyrë të përhershme në rastet e mëposhtme: a) kur nuk ka një numër të mjaftueshëm gjyqtarësh ose prokurorësh në një gjykatë ose prokurori; ose b) kur gjyqtarët ose prokurorët e një gjykate ose prokurorie janë ligjërisht të padisponueshëm për gjykimin ose hetimin e një apo disa çështjeve”.

Ndërsa sipas preambulës së Vendimit të Këshillit nr.30, datë 14.02.2019, rregullat sipas këtij vendimi janë të zbatueshme vetëm “në rastet kur skema e delegimit dhe

transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t'iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave”.

Aktualisht, në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshilli shërbejnë katërbëdhjetë gjyqtarë, të cilët, për shkak të nevojave emergjente, janë caktuar në pesë gjykata të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, në një gjykatë të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ, si dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Nga gjyqtarët e skemës së delegimit, gjashtë prej tyre, konkretisht gjyqtarët {...} – {...}, kanë kandiduar për ngritjen në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, ku në kuadër të kandidimeve ata dhe familjarët e afërt të tyre kanë plotësuar dhe dorëzuar rregullisht formularët e vetëdeklarimit për dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Gjyqtarët e tjerë të skemës së delegimit nuk kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit të lartpërmendur.

Ndërkohë, nga gjyqtarët e skemës së delegimit që plotësojnë kushtet shtesë të sigurisë, tre prej tyre, konkretisht gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, ndërsa plotësojnë kriteret për t'u caktuar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk i plotësojnë ato sa i përket caktimit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pikërisht të kriterit të përvojës minimale profesionale sipas shkronjës “b”, pika 2, të nenit 47, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga ana tjetër, tre gjyqtarët e tjerë të skemës së delegimit që plotësojnë kushtet shtesë të sigurisë, pra gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, rezulton të plotësojnë kriteret për t'u caktuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, verifikuar kjo në kuadër të procedurës së verifikimit sa i përket kandidimeve të tyre për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë, referuar për këtë respektivisht Vendimeve nr. 355, nr. 354, datë 09.09.2021 dhe nr. 162, datë 14.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Vlen të përmendet se të tre gjyqtarët në fjalë të skemës së delegimit janë konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar.

Në kushtet kur në listën e gjyqtarëve të skemës së delegimit janë tre gjyqtarë që plotësojnë kushtet dhe kriteret për t'u caktuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, atëherë për plotësimin e nevojave në rastet konkret në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pra për caktimin e një gjyqtari në atë çështje, është i nevojshëm organizimi i shortit midis këtyre tre gjyqtarëve, sikurse parashikohet në nenin 13, të Rregullores për Kriteret dhe Procedurën e Funkcionimit të Skemës së Delegimit të Gjyqtarit, miratuar me Vendimin e Këshillit nr.22, datë 07.02.2019.

Në vijim, duhet të evidentohet se tre gjyqtarët e skemës së delegimit që plotësojnë kushtet dhe kriteret për t'u caktuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pra gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, nuk kanë pengesa të dukshme për gjykimin e çështjes në nevojë në këtë gjykatë, referuar për këtë informacionit të dërguar nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në rrugë elektronike, me emalin e datës 02.12.2021.

Ndaj sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit (që mbetet të përcaktohet), për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në 2 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtari i skemës së delegimit z./znj. \_\_\_\_\_ (gjyqtari që do të përzgjidhet nga shorti) caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit/es \_\_\_\_\_ (gjyqtarit sipas pikës 1), sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi, konkretisht menjëherë dhe publikimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

*(Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime, ndaj propozimet e Komisionit konsiderohen të miratuara. Vijohet me procedurën e shortit.)*

Për çështjen me nr. 47, përzgjidhet gjyqtari {...}.

Hidhet në votim projektvendimi:

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

Vijohet me nënçështjen e tretë dhe të fundit e cila ka të bëjë me projektvendimin “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”. Janë përgatitur relacionet e 7 gjykatave që kanë paraqitur nevojë për caktim gjyqtarësh.

Fillimisht zoti Toska relaton shkurtimisht relacionin sa i përket radhës së shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

A. Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksioneve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm:

1. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës:

a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

2. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër:

a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë;

b. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës.

3. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë:

- a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.
- II. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ:
  - a. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë.
  - B. Gjykatat e apeleve, sipas kësaj radhe:
    - I. Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm:
      - 1. Gjykata e Apelit Korçë;
      - 2. Gjykata e Apelit Vlorë.

Pasi anëtarët janë dakord me radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë (gjyqtarët e transferuar përkohësisht në këtë gjykatë) ose Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen, të jetë 1.

Propozimet vijues i Komisionit është:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti Kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, konkretisht: Znj. Emona Muçi.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, të cilët kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: Z. {...};

Z. {...}; Znj. {...}.

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, të mos përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e saj, konkretisht: Znj. Diamela Goxha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtari Artan Jahollari.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** ka paraqitur nevojë për 5 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 (pesë) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 (pesë) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 6 (gjashtë).

Për 3 (tre) çështje, ato nr.1-3, për të cilat kërkohet nga 1 (një) gjyqtar, të caktohen 3 (tre) të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Për 2 (dy) çështje, ato nr.4-5, për të cilat kërkohet nga 1 (një) dhe 2 (dy) gjyqtarë, të caktohen 3 (tre) të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Propozimet vijues i Komisionit është:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti Kryetarët në detyrë të Gjykatave të Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Kurbin, konkretisht: Z. Edvan Veçani; Z. Ded Miri.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Ardit Kuka.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Nertila Kape.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Xhevdet Lika.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarët Aurel Arapi dhe Olti Skrame.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarja Alda Sadiku.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë.



Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijues i Komisionit është:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht të ulët dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, të mos përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e kësaj gjykate, konkretisht: Znj. Enkeleda Dalipi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtari Aulon Pashaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijues i Komisionit është:

Në shortimin e çështjes, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Mat, të mos përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i kësaj gjykate, konkretisht: Z. Artan Çupi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtari Artan Çupi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, përfshirë dhe gjyqtarët e transferuar përkohësisht pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijues i Komisionit është:

Në shortimin e kësaj çështje të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, konkretisht: Z. Bevis Shehaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtarja Ema Shaholli.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4 (katër).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: Z. Ridvan Hado.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Edlira Petri dhe Elona Toro.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Valdete Hoxha dhe Genti Shala.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të fundit “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 6 çështje gjyqësore.

Lidhur me kërkesat me numër rendor 1 dhe 2, që në të dy rastet është kërkuar caktimi i tre gjyqtarëve, me shkresën nr. {...} prot., datë 16.11.2021, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor i është kërkuar informacion Gjykatës së Apelit Vlorë në lidhje me kërkesat me numër rendor 1 dhe 2 në tabelë. Konkretisht, marrë shkas nga sa pasqyrohet në kërkesat respektive të Gjykatës së Apelit Vlorë është kërkuar informacion nëse gjyqtarët e tjerë që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Apelit Vlorë janë ligjërisht të padisponueshëm për gjykimin e atyre çështjeve gjyqësore, pra nëse ka një akt formal që i përjashton ata nga gjykimi i çështjeve gjyqësore në fjalë, akt ky i nxjerrë në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurës Civile, në të cilin përcaktohen rastet e përjashtimit dhe të dorëheqjes së gjyqtarit, sikundër dhe procedura që ndiqet për shqyrtimin e kërkesave respektive.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Gjykata e Apelit Vlorë me shkresën nr. {...} prot., datë 19.11.2021 (protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., datë 26.11.2021), ka bërë me dije se: “...në asnjë prej dosjeve nuk ka akte të tjera që shprehin papajtueshmërinë e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve, parashikuar nga neni 72 pika 6 e Kodit të Procedurës Civile. Në këto rrethana çështjet e sipërcituara do të shortohen midis gjyqtarëve të cilët nuk rezultojnë të kenë pengesë ligjore”.

Në këto kushte, është vendi që Këshilli të vendosë për deklarin e përfunduar të çështjeve pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenet 90/3 dhe 94/1 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 97/3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Nisur nga rrethanat si më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Apelit Vlorë, për caktim gjyqtari, si vijon:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 12.11.2020 dhe nr. {...} prot., datë 14.10.2021, për caktim gjyqtari në çështjen gjyqësore, që u përket palëve, paditës {...} etj, e paditur {...}, me objekt “Shpërblim dëmi”;

2. Kërkesës nr. {...} prot., datë 04.11.2021 për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore që u përket palëve, paditës {...} etj, e paditur {...}, person i tretë {...}, me objekt “Shpërblim dëmi”.

*(Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime, ndaj propozimi i Komisionit konsiderohet i miratuar.)*

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, sa i përket kërkesave me numër rendor 3-6, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 (katër) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastrë, përfshirë dhe gjyqtarin e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 (katër) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4 (katër).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, konkretisht: Z. Dritan Banushi.

Në shortimin e çështjes nr. 3 të përjashtohet nga gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, i cili është caktuar më herët për gjykimin e çështjes, konkretisht: Z. Sokol Pina.

Në shortimin e çështjeve nr.5 dhe nr. 6, të përjashtohet nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, i cili është caktuar më herët për gjykimin e tyre, konkretisht: Z. Enton Dhimitri.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtari Sokol Pina.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarja Irena Brahim.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtari Enton Dhimitri.

Për çështjen nr. 4, civile, gjyqtarja Miranda Andoni.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**